

i kuajtur *Male te Mrizet* në Senik. I biri i Hyres, Hajrullahu, i ka varrosur trupat e Hyres dhe të Altinit në varrezat familjare në Senik më 1.9.1998.

Pas lufte, më 30.03.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Zades në varrezat në Balincë/Balinçe. Në datën 23.8.2001, familja Halitaj i ka rivarrosur mbetjet mortore të Halimes në varrezat e Senikut/Senik. Në të njëjtin muaj, mbetjet mortore të Elvanes dhe Valentines janë rivarrosur në varrezat e Banjës/Banja. Familja Shala edhe sot e kësaj dite është duke kërkuar ndriçimin e fatit të trupit të Xhaferit të vogël. Në listën e KNKK-së, rasti i tij i zhdukjes është evidentuar në dosje me numër rendor BLG-803923-01.

**Burimet:** deklarata J.H, FDH-3562; deklarata Š.S, FDH-3563; deklarata R.H, FDH-3566; deklarata J.Z, FDH-3567; deklarata J.Z, FDH-3568; deklarata L.S, FDH-15140; deklarata S.S, FDH-15170; deklarata S.K, FDH-16016; deklarata B.K, FDH-33478; deklarata N.H, FDH-34651; deklarata H.R, FDH-34650; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-23857; J. Osmani, *Krimet...*, I, 536.

## Vezi re (Hajdin Suka) Zulfaj

(7.07.1954, shqiptare nga Seniku/Senik, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise, pesë fëmijë)

## Kujtim (Rifat) Morina

(15.03.1986, shqiptar nga Astrazupi/Ostrozub, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënës)

Në muajin korrik të vitit 1998, Kujtimi me nënën Sevdijen, vëllezërit dhe gjyshen e braktisën Astrazupin/Ostrozub dhe u strehuan në Senik, te daja Smajl Zulfaj dhe bashkëshortja e tij Vezi re. I ati Rifati i punonte në Gjermani. Në të njëjtën kohë, te Smajli ishin strehuar afro 50 refugjatë nga fshatrat përreth.

Në datën 26.08.1998, një kolonë ushtarake ka ardhur nga drejtimi i Malishevës/Mališevo. U stacionua te lagja *Zulfaj*, ku gjendej shtëpia e Smajlit. Në ato çaste, në shtëpinë e tij gjendeshin afro 90 persona, 60 prej tyre familjarët e zotit të shtëpisë dhe 30 refugjatë. Që të gjithë e braktisën shtëpinë dhe u nisën drejtë kodrave në hy-

rje të fshatit. Të nesërmen, ushtria serbe ka depërtuar deri te Kleçka/Klečka [Lipjan/Lipljan], duke e bombarduar popullatën që gjendej në majën e bjeshkës [të shikohet regjistrimi i mëparshëm]. Në datën **28.08.1998**, herët në mëngjes, familjarët e Smajlit dhe refugjatët që ishin të strehuar tek ai u nisën për në fshat. Shkuan në shtëpinë e vjetër të Smajlit, që gjendej në qendër të **Senikut/Senik**. Turma e të zhvendosurve i numëronte afro 200 persona. Rreth orës 8:00, forcat serbe filluan me bombardimin e fshatit. U plagosën më tepër se 20 persona, kryesisht gra dhe fëmijë. Plagët më të rënda i kanë marrë Kujtimi dhe Vezi reja. Vëllezërit e Kujtimit, Urimi dhe Avniu, e quan Kujtimin e plagosur në pyll që gjendet në drejtim të Bellanicës/Belanica, përderisa Vezi ren dhe persona të tjerë të plagosur i quan te përroska e fshatit. Pastaj, që të gjithë të plagosurit u transferuan në shtëpinë e Misin Jonuzit, ku një teknik mjekësor u dha ndihmën e parë. Të nesërmen, herët në mëngjes, Vezi reja ka ndërruar jetë nga plagët vdekjeprurëse. E varrosën po atë ditë në një pyll të Senikut/Senik. Rreth orës 11:00, përfaqësuesit e KNKK-së e kanë çuar Kujtimin dhe personat e tjerë të plagosur në spitalin e Prishtinës/Priština. Kujtimi ndërroi jetë pas pranimit në spital. Në datën 3.09.1998, Jashar Buqaj e ka kthyer trupin e Kujtimit të vogël në Senik. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Kujtimin në varrezat familjare në Astrazup/Ostrozub. Pas lufte, në datën 27.08.2001, familja Zulfaj i ka varrosur mbetjet mortore të Vezi res në varrezat e Senikut/Senik.

**Burimet:** deklarata A.Z, FDH-14783; deklarata S.M, FDH-15659; deklarata Z.Z, FDH-3560; deklarata S.Z, FDH-3561; deklarata J.H, FDH-3562; deklarata X.Z, FDH-3565; deklarata J.Z, FDH-3567; deklarata J.Z, FDH-3568; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-23857.

## Selman (Rrustem) Kafexholli

(2.06.1926, shqiptar nga Bellanica/Belanica, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, një fëmijë)

Selmani nuk kishte fëmijë. E kishte